

VENDIM
Nr.89, datë 9.2.2022

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RIKONSTRUKSIONIT TË GODINAVE, SPITALI “SHENJTA MARI” DHE DREJTORIA E
SHËNDETIT PUBLIK (ISH-SPITALI INFEKTIV), NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN,
BASHKIA MIRDITË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË MIRDITË SI NJËSI ZBATUESE**

(Ndryshuar me VKM nr. 796, datë 12.12.2022; nr. 669, datë 6.12.2023)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të godinave, spitali “Shenjta Mari” dhe Drejtoria e Shëndetit Publik (ish- Spitali Infektiv), Njësia Administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë, në masën 413 452 654 (katërqind e trembëdhjetë milionë e katërqind e pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

2. Bashkisë Mirditë, në buxhetin e vitit 2022, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 82 690 530 (tetëdhjetë e dy milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të godinave, spitali “Shenjta Mari” dhe Drejtoria e Shëndetit Publik (ish-Spitali Infektiv), Njësia Administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë, që do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022.

2/1. Përveç përcaktimeve të pikës 2, të këtij vendimi, Bashkisë Mirditë, në buxhetin e vitit 2022, i transferohet në formën e transfertës së pakushtëzuar, fondi në masën 75 194 683 (shtatëdhjetë e pesë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të godinave, spitali “Shenjta Mari” dhe Drejtoria e Shëndetit Publik (ish-Spitali Infektiv), Njësia Administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë, që do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022.

2/2. Bashkisë Mirditë, në buxhetin e vitit 2023, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 250 611 639 (dyqind e pesëdhjetë milionë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të godinave, spitali “Shenjta Mari” dhe Drejtoria e Shëndetit Publik (ish-spitali infektiv), Njësia Administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë, që do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023.

3. Caktimin e Bashkisë Mirditë si njësi zbatuese për financimin e rikonstruksionit të godinave, spitali “Shenjta Mari” dhe Drejtoria e Shëndetit Publik (ish-Spitali Infektiv), Njësia Administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë.

4. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama